



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë nenit 3.1, pikat b dhe h të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par.1, pika b dhe ë të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2006, merr

V E N D I M
PËR REALIZIMIN E PËRMBAJTJEVE TË PLANIT RREGULLUES “QENDRA 2” NË PRISHTINË NË BAZË TË KONTRATËS MBI KONCESIONIN

Neni 1

Miratohet Vendimi për realizimin e përmbajtjeve të planit rregullues “ Qendra 2” në Prishtinë në bazë të kontratës mbi koncesionin.

Neni 2

Realizimi i përmbajtjes së planifikuar me planin nga neni 1 i këtij Vendimi sipas kontratës mbi koncesionin, përmban pjesën e këtij plani, të emërtuar si Z12, me përmbajtje për ndërtimin e garazhit nëntokësor, objekteve afariste dhe përmbajtjeve tjera përcjellëse.

Kriteret urbane të përmbajtjeve nga par.1 i këtij neni1, të cilat përfshijnë një hapësirë prej 2.94.89 ha ,mbi pjesën e ngastrës kadastrale nr. 7090/1 - Zona kadastrale - Prishtinë, janë të përcaktuara me planin rregullues “Qendra 2”, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr.01-35-19427, të dt. 19.08.2005.

Neni 3

Realizimi i përmbajtjes së planifikuar sipas kontratës mbi koncesionin, do të bëhet përmes ofertave publike dhe procedurave tjera ligjore, të parapara për dhënie me koncesion.

Neni 4

Para nënshkrimit të kontratës me koncesionarin e zgjedhur sipas procedurës nga neni 3 i këtij Vendimi, kontratën do ta shqyrtojë dhe miratojë Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Për realizimin e përmbajtjes së planifikuar sipas këtij Vendimi dhe kushteve të përcaktuara me kontratën mbi koncesionin, do të kujdeset kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës përmes Bordit të drejtorëve.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. 35-589, më 27.12.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri